



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 171 prot.

Kamëz, më 19.12.2024

V E N D I M

Nr. 127 Datë 19/12 2024

MBI

“NJË NDRYSHIM TË VKB NR.09 DATË 23.01.2023 MBI: “ MIRATIMIN E LISTËS SË SUBJEKTEVE, POSEDUES TË NDËRTIMEVE PA LEJE QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT UNAZA E MADHE E TIRANËS, SHESHI SHQIPONJA, BULEVARDI I RI, SHKOZË PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE PASKUQAN, TË CILËT PËRFITOJNË SUBVENCIONIM TË QIRASË SIPAS PARASHIKIMEVE TË VKM NR. 409, DATË 15.06.2022 “PËR RREGULLAT, MËNYRAT DHE AFATET E TRAJTIMIT TË POSEDUESVE TË NDËRTIMEVE PA LEJE QË NUK LEGALIZOHEN”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 19.12.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.96 Datë 13.12.2024 në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative së Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr.22/2018 “Për strehimin social”; Ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr.409, datë 15.06.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve pa leje që nuk legalizohen”; Urdhër i Kryetarit të Bashkisë Kamëz me nr.571 prot, datë 15.07.2022 “Për ndjekien dhe trajtimin e poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga realizimi i projektit Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja - Bulevardi i Ri, Shkozë”, Vendimi i Këshillit Bashkiak Kamëz me nr.92, datë 19.07.2022 “Mbi miratimin e vlerës së subvencionimit të qirasë për familjet që preken nga projekti Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja-Bulevardi i Ri, Shkozë, Njësia Administrative Paskuqan”; VKB nr.99, datë 27.07.2023 Mbi miratimin e manualit të procedurave për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga realizimi i projektit Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja-Bulevardi i Ri, Shkozë, Njësia Administrative Paskuqan; Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit të listës së subjekteve përfitues të cilët kanë nënshkruar “Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Bashkinë Kamëz për Zbatimin e Projektit Unaza e Madhe e Tiranës Sheshi Shqiponja-Bulevardi i Ri, Shkozë, Njësia Administrative Paskuqan”si më poshtë:
Në vendimin me nr. 09 datë 23.01.2023 të ndryshohet emri nga _____ në emrin _____ me nr. ID sipas nënshkrimit të marrëveshjes me nr. prot 258 datë 20.01.2023.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi i Punës i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë me nr.571 prot, datë 15.07.2022 “Për ndjekien dhe trajtimin e poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga realizimi i projektit Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja - Bulevardi i Ri, Shkozë” i ndryshuar dhe Drejtoria Emergjencave Civile dhe Strehimit.
3. Ky vendim, hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI

